



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:063372

Datë: 06.02.2025

Numri i dokumentit: 06816970

**C. nr. 110/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura shtetërore me seli në Prishtinë me përfaqësuese Fitore Byqmeti, kundër të paditurit A.B. nga ..... të cilin me autorizim e Selmon Sadiku avokat në Kamenicë, me objekt kontesti për kthimin e mjeteve financiare të paradhënies për shkak të mos përmbushjes së kontratës, vlera e kontestit prej 6,194.50 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e palëve ndërgjyqëse, më datën 03.02.2025, e përpilojë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe **DETYROHET** i padituri A.B. nga .....që shumën e mjeteve prej 1,194.00 euro, ti kthej në llogarinë e paditësit, me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

**II. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në shumë prej 5,000.5, shumë kjo përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **SI E PABAZUAR.**

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Paditësja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datën 30.03.2022, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurit A.B. nga ....., për kthimin e mjeteve financiare të paradhënies për shkak të mos përmbushjes së kontratës, me vlerë të kontestit prej 6,194.50 euro.

### **1. Pretendimet e palës ndërgjyqëse**

Avokatja shtetërore Fitore Byqmeti si përfaqësuese e paditëses, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë të dorëzuar në gjykatë, duke theksuar se është bërë nënshkrimi i kontratës me datë 05.01.2021 e cila do të fillonte së implementuari nga data 15.02.2021 duke u nisur nga parimi se afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit me datë 15.05.2021, ku pavarësisht kësaj paditësja duke i dhënë mundësi të gjithë fermerëve të kanë problem me investim që deri me datë 19.11.2021 të paraqesin kërkesë për pagesë, por që i padituri nuk ka kryer investimet edhe pse kishte kohë përafërsisht 6 muaj, prandaj i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadija e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

dhe kërkon nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë si të bazuar.

I autorizuari i të paditurit, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet pranë përgjigjes në padi, dhe se është e vërtetë se paditësi ka pranuar grant në shumë prej 6.194.50 euro edhe atë për rregullimin e dhomës së mjaltit, meqë merret me këtë veprimtari, ka të regjistruar biznes me emër A.I.B. B.I, dhe ka propozuar që këtë çështje ta zgjidhë edhe me marrëveshje jashtëgjyqësore apo pajtim gjyqësor. Ka propozuar gjykatës që padinë e paditëses ta aprovoj vetëm pjesërisht edhe atë për shumën 1,194.00 euro, kurse pjesën tjetër të kërkesëpadiisë në shumë prej 5,00.5 euro ta refuzoj si të pa bazuar pasi që pala e paditur duke u bazuar në nenin 8 të kontratës 330/20 ka qenë e penguar nga rrethanat e pa parashikuara të cilat kanë ardhë si rezultat i pandemisë që sipas tij këto rrethana e kanë penguar të paditurin ta realizoj në tërësi kontratën.

### **2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale dhe personale: Kërkesa për iniciimin e procedurës gjyqësore për kthimin e mjeteve financiare te përfituara si paradhënie me nr. te prot.471, e dt.31.01.2022, Vendimi për përjashtim për tri vite nga programet përkrahëse me nr. te prot.1351, dt.21.03.2022, Njoftimi për ndërprerje te Kontratës dhe kthimin e mjeteve te paradhënies me nr. te prot.7519, e dt.31.12.2021, Lista e përfitueseve për Masën 302 për programin e vitit 2020 me nr. te prot.2193, te dt.30.04.2021, Vendimi për paradhënie për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural me nr. te prot.2194, te dt.30.04.2021, Vendimi për paradhënie për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural me nr. te prot.1822, te dt.19.04.2021, Lista e përfitueseve për Masën 302 për programin e vitit 2020 me nr. te prot.1821, te dt.19.04.2021, Certifikata e regjistrimit ne ARBK me nr. unik identifikues 810334839, te dt.10.08.2020, Letër informimi – Miratimi i projektit me nr. te prot. 58, te dt.05.01.2021, Police për sigurimin e garancisë se tenderit dhe ekzekutimit te kontratës , me nr.91223, te dt.10.03.2021, Kërkesa për avans masa 302 diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve 2020/2021, i dt.10.03.2021, Shkresa Masa 302 diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, 302.1 prodhimi i mjaltit, i dt.29.12.2020, Kontrata e Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë për financimin e projekteve investuese te zhvillimit rural me nr.330/20, edt.29.12.2020, Raporti nga kontrolli ne teren i Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë te dt. 09.12.2020, Foto dokumentacioni i dt.09.12.2020, Certifikata e regjistrimit te fermerit me nr.1090367 ne emër te A.B. te dt.16.10.2019, Vërtetimi tatimor ne emër te A. B., me nr.1000727561, Projekt propozim – zgjerimi i biznesit prodhues te mjaltit Gusht 2020, Fatura me nr.3/2021 e dt.07.12.2021, Fotografitë.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, komfor dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

## **2.1. Provat materiale**

Në bazë të kërkesës për iniciimin e procedurës gjyqësore për kthimin e mjeteve financiare te përfituara si paradhënie me nr. te prot.471, e dt.31.01.2022, gjykata vërtetoi faktin se Drejtoria e Autorizimit të Pagesave ka kërkuar iniciimin e e procedurës gjyqësore ndaj të paditurit A.B. për kthimin e mjeteve të përfituara.

Në bazë të vendimit për përjashtim për tri vite nga programet përkrahëse me nr. te prot.1351, dt.21.03.2022 gjykata vërtetoi faktin se, i padituri A.B. është përjashtuar nga programet përkatëse për tre vite me arsyetimin se pas përfundimit të procedurave Drejtoria e Autorizimit të Pagesave më datë 31.12.2021 ka njoftuar përfituesin për shkëputjen e kontratës dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve të dhëna në formë paradhënie i cili nuk i është përgjigjur kërkesës për kthim.

Në bazë të njoftimit për ndërprerje të kontratës dhe kthimin e mjeteve të paradhënies me nr. te prot.7519, e dt.31.12.2021 gjykata vërtetoi faktin se kontrata me numër 330/2020 e datës 05.01.2021 është shkëputur në mënyrë të një anshme.

Në bazë të listës së përfitueseve për Masën 302 për programin e vitit 2020 me nr. te prot.2193, te dt.30.04.2021 gjykata vërtetoi faktin se paditësja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kërkuar nga zyrtarët kryesor të financave të bëjnë ekzekutimin e pagesës për listat e fermerit/ kompanisë përfituese për Masën 312.1.

Në bazë të vendimit për paradhënie për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural me nr. te prot.2194, te dt.30.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se ky vendim është bërë për të paditurin A.B. me qëllim të zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2014-2020, ku objekt i këtij vendimi ka qenë përkrahja e përfituesit për të ristrukturuar potencialin fizik në sektorin argo-rural në Kosovë.

Në bazë të vendimit për paradhënie për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural me nr. te prot.1822, te dt.19.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se ky vendim është bërë për të paditurin A.B. me qëllim të zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2014-2020, ku objekt i këtij vendimi ka qenë përkrahja e përfituesit për të ristrukturuar potencialin fizik në sektorin argo-rural në Kosovë.

Në bazë të listës së përfitueseve për Masën 302 për programin e vitit 2020 me nr. te prot.1821, te dt.19.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se në këtë listë është përfitues i padituri A.B..

Në bazë të Certifikata e regjistrimit në ARBK me nr. unik identifikues 810334839, te dt.10.08.2020, gjykata vërtetoi faktin se emri i biznesit ka qenë i regjistruar me emër A.I.B. B.I.

Në bazë të letër informimi – Miratimi i projektit me nr. te prot. 58, te dt.05.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se i padituri pas kontrollit administrativ, kritereve të vlerësimit dhe kontrollit të parë në terren nga paditësja, i ka plotësuar kriteret për fillimin e investimeve sipas Udhëzimit Administrativë nr.02/2020.

Në bazë të polices për sigurimin e garancisë se tenderit dhe ekzekutimit të kontratës , me nr.91223, të dt.10.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se kontraktues ka qenë A. I.B. B.I i përfaqësuar nga A.B..

Në bazë të kërkesës për avans masa 302 diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve 2020/2021, i dt.10.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se kjo kërkesë është në emër të të paditurit A.B. i cili edhe e ka nënshkruar këtë kërkesë për avans, ku vlera totale e këtij projekti ka qenë 19,060.00 euro, vlera për përkrahje publike ka qenë 12,389.00 euro dhe 50% e vlerës së përkrahjes publike (paradhënie) 6,671.00 euro.

Në bazë të letër informimi – Miratimi i projektit me nr. të prot. 58, të dt.05.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se i padituri pas kontrollit administrativ, kritereve të vlerësimit dhe kontrollit të parë në terren nga paditësja, i ka plotësuar kriteret për fillimin e investimeve sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2020.

Në bazë të shkresës Masa 302 diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, 302.1 prodhimi i mjaltit, i dt.29.12.2020, gjykata vërtetoi faktin se pas kontrollit administrativ, Kriteret të vlerësimit dhe Kontrollit të Parë në terren, projekti i juaj i plotëson kriteret për fillimin e investimeve sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2020, në shumë maksimale të pranuar të investimit 19,060.00 euro .

Në bazë të kontratës së Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural me nr.330/20, dt.29.12.2020, gjykata vërtetoi faktin se kjo kontratë është nënshkruar në mes të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë MPBZHR dhe A.B. B.I, për Masa 302-2 Diversiteti i fermave dhe zhvillimi i bizneseve- 302.1.- Prodhimi i mjaltit.

Në bazë të raportit nga kontrolli në teren i Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë të dt. 09.12.2020, gjykata vërtetoi faktin se nga konstatimet e inspektorëve gjatë kontrollit është vërtetuar se vendi i investimit ndodhet në fshatin Bllatë, Komuna e Kamenicës, me projekt për zgjerimin e biznesit-prodhimit të mjaltit, ku kanë vlerësuar këtë gjendje, fleta poseduese dhe kopja e planit përputhet me terrenin dhe vendin e investimit, bletët e verifikuara kanë qenë 52 kosha, ndërsa asetet e kërkuara me projekt propozim kanë qenë disa që kanë munguar, po ashtu fermeri nuk ka qenë përfitues më parë në AZAB.

Në bazë të foto dokumentacioni i dt.09.12.2020 gjykata vërtetoi se në këto fotografi shihet i padituri pranë koshereve të tij të bletëve, ndërsa në fotografitë tjera shihet paditësi në vendin ku ka qenë e destinuar të ndërtohet dhoma e mjaltit.

Në bazë të Certifikatës së regjistrimit të fermerit me nr.1090367 në emër të Ali Berishës të dt.16.10.2019 gjykata vërtetoi faktin se, A.I. B. B.I me numër të biznesit 810334839 dhe numër fiskal 810334839 është fermer i regjistruar me numër identifikues të fermës 1090367.

Në bazë të vërtetimit tatimor në emër të A. B., me nr.1000727561, Projekt propozim – zgjerimi i biznesit prodhues të mjaltit Gusht 2020, gjykata vërtetoi faktin se, fermeri A. B. është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pa shlyera apo obligime të tjera tatimore dhe posedon bletari në fshatin Bllatë, Komuna e Kamenicës.

Në bazë të projekt propozim – zgjerimi i biznesit prodhues të mjaltit Gusht 2020 gjykata vërtetoi faktin se, aplikues për këtë projekt ka qenë i padituri A.. ku emërtimi i investimit ka qenë Zgjerimi i biznesit prodhues të mjalti- dhoma e mjaltit ku paditësi ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punoj që të arrij të krijoj një bletari të suksesshme dhe se aktualisht ka 52 koshere me bleta dhe synon që sa më shpejt të arrij deri në numrin 250 të koshereve, vendi ku investimi do të bëhet është fshati Bllatë, Komuna e Kamenicës dhe qëllimi kryesor i këtij biznesi është të vazhdoj drejt sukseseve të mëtutjeshme, rritjes së të hyrave dhe fitimeve, punësimit të punëtorëve dhe furnizimin e qytetarëve me produkte cilësore.

Në bazë të faturës me nr.3/2021 e dt.07.12.2021 gjykata vërtetoi faktin se, i padituri si punëdhënës në emër të ndërtimit dhe kompletimit të dhomës së mjaltit i ka deponuar shuma prej 5005.00 euro punëmarrësit, ndërmarrja ndërtimore ”Te Kulla”.

Në bazë të dy fotografive në fleta A4, gjykata vërtetoi faktin se shihet qartë objekti i ndërtuar si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.

Gjykata ka administruar edhe prova tjera materiale por, të njëjtat nuk i ka vlerësuar dhe nuk i ka marrë për bazë me rastin e vendosjes, ngase për gjykatën ishin të pa rëndësishme dhe jo relevante lidhur me këtë çështje juridike kontestimore.

### **3. Baza juridike**

Andaj, duke i pasur parasysh faktet e lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim që padia dhe kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht bazuar në ligj dhe e aprovoj pjesërisht të njëjtën si të tillë, duke u bazuar në dispozitën e nenit 7, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e në rastin konkret paditësja nuk i ka ofruar – prezantuar gjykatës asnjë provë konkrete dhe relevante për të vërtetuar pretendimin e sajë se i padituri A.B.

të ketë keqpërdorur subvencionet të përfituara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Po ashtu, duke u bazuar në dispozitën e nenit 319, paragrafi 1, të LPK-së, ku përcaktohet se “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”, në rastin konkret paditësja nuk ka mundur t’i provojë në asnjë mënyrë thëniet dhe pretendimet e tij gjatë shqyrtimit kryesor, përkatësisht faktin se i padituri A.B. të ketë keqpërdorur subvencionet të përfituara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht se të njëjtat nuk i ka përdorur në pajtim me destinimin e marr, prandaj paditësi nuk ka arritur që ta bind gjykatën me asnjë provë konkrete dhe relevante, andaj edhe mbi këtë bazë ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar në ligj dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### **4. Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës**

Duke i marrë parasysh dëshminë e vetë paditësit, provat materiale të lartcekura dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret, padia dhe kërkesëpadia e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është pjesërisht e bazuar në ligj, deri të ky përfundim gjykata erdhi duke e pasur parasysh faktin se paditësja me asnjë provë të vetme konkrete dhe relevante nuk ka mundur ta provoj dhe ta bind gjykatën se i padituri A.B., ka keqpërdorur subvencionet të përfituara nga paditësja, përkatësisht se i njëjti nuk i ka përdorur të njëjtat në pajtim me destinimin, andaj gjykata erdhi në përfundim se i padituri, ka aplikuar për përfitimin e subvencionit në procedurë të hapur dhe konkurruese, ka arritur të përfitoj grantin në shumën e lartcekur, të njëjtin e ka shfrytëzuar për ndërtimin e dhomës së mjaltit, në firmën përkatëse “Te Kulla” të cilës i ka deponuar me fletëpagesë, çmimin prej 5005.00 euro, dhe se për këtë ndërtim i ka kryer të gjitha pagesat përmes bankës, me datë 07.12.2021, andaj pretendimi i përfaqësuesit të paditëses se i padituri nuk i ka shfrytëzuar mjetet në raport me destinimin mbetet si i pabazuar, mbeti vetëm një pretendim i paargumentuar, ngase i padituri edhe pse barra e provës nuk bie mbi të, me fletëpagesat e transaksioneve të shitblerjes, ja vërtetoi kësaj gjykate se, dhomën e mjaltit e ka ndërtuar si në fotografitë e bashkangjitura përgjigjes në padi si në shkresat e lëndës, kështu duke paguar çmimin prej 5,005.00 euro për ndërtimin e sajë, ndërsa dhoma nuk kishte arritur të kompletohej për shkak të pandemisë dhe pjesa e mbetur prej 1,194.00 euro ishte e destinuar për blerjen e makinerisë përcjellëse, andaj

edhe për pjesën e mbetur në shumë prej 1,194.00 euro i padituri është i gatshëm ta kthejë, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që sa i përket pjesës 1,194.00 euro, ta aprovojë si të bazuar.

Meqenëse në rastin konkret paditësja nuk i ka ofruar gjykatës prova mbi bazën e të cilave do t'i mbështeste pretendimet e tij, se i padituri A.B., i ka shkaktuar dëm material paditëses përkatësisht se i njëjti nuk e ka shfrytëzuar subvencionin e marrë nga e paditura në pajtim me destinimin, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe atë vetëm për shumën 1,194.00 euro, ndërsa në mungesë të provave mbi bazën e të cilave do të mund të vërtetohej gjendja faktike ndryshe nga ajo që është vërtetuar në këtë procedurë sa gjykata refuzoi pjesën tjetër në shumë prej 5,000.5, përtej shumës së aprovuar.

#### **5. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u bazuar në nenin 450, të LPK-së, ashtu që secila palë ndërgjyqëse t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, krejt kjo duke e pasur parasysh faktin se asnjëri nga palët nuk i ka përcaktuar dhe kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat si më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 7 dhe 319, e lidhur me dispozitën e nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2022:063372, 03.02.2025**

**G j y q t a r j a,  
Valbonë Dërvodeli**

**,d.v.**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.